

U zhvillua një takim me studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike

Më datën **20 Mars 2015**, në kuadrin e përfshirjes së Edukimit në fushën e Standardizimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit me Universitetet, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) realizoi një takim në ambientet e Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), me studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.



Në këtë veprimtari, nga DPS morën pjesë Znj. Kostanca Dedja – Drejtore, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Palët dhe Znj. Anita Reçi dhe Znj. Olta Bane – Specialiste në Sektorin e Promovimit dhe Marketingut, ndërsa nga UPT ishin të pranishëm, Z. Përparim Deçolli - Pedagog i lëndës: "Menaxhimi Industrial i Cilësisë", njëkohësisht anëtar i Bordit Drejtues të DPS dhe mbi 70 studentë të vitit të tretë të Inxhinierisë Mekanike.

Bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT) ka qënë shumë i mirë dhe i vazhdueshëm, përmendim këtu:

- bashkëpunimin në nivel drejtues - përfaqësues nga UPT janë antarë të bordit Drejtues të DPS-së;
- bashkëpunim në nivel teknik – pjesëmarrës në Bordin Teknik si dhe Anëtarë e Kryetarë të Komiteteve Teknike të DPS-së.

Takimi me studentët

Në një nga auditorët e UPT-së u zhvillua një takim me studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, gjatë të cilit u bë edhe një prezantim në fushën e standardizimit, nga Znj. Kostanca Dedja.



Prezantimi ishte organizuar në formën e një informacioni të përgjithshëm mbi sistemin e standardizimit dhe mënyrën e funksionimit të tij, FAQ (Pyetje/Përgjigje të shpeshta) duke iu dhënë përgjigje pyetjeve; Çfarë është një standard? Çfarë bëjnë standardet për Ju? Si mund të bli një standard? A aplikon DPS ulje në çmimin e standardeve? etj.

Shembuj standardesh konkret u diskutuan për të kutpuar çfarë është një standard dhe roli i tij për përdoruesit.

Në fund të prezantimit studentët u njohën me publikimet e DPS, materiale këto që mund t'i ndihmojnë gjatë procesit të studimit apo edhe në zhvillimin e temave të diplomës në këtë fushë.

Gjithashtu, DPS prezantoi të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion (tel., fax., faqja e internetit, Profilet e DPS-së në mediat sociale) dhe shërbimet që ajo ofron.

Studentëve, në përfundim të takimit, iu shpërndanë kopje të publikimeve; Rreth DPS (misioni, organizimi, publikime e rëndësishme, kontakte etj), botime mbi rëndësinë dhe përfitimet nga përdorimi i standardeve dhe krijimin e përfitimeve nga standardet për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME-të) dhe materiale promocionale.

Më poshtë disa nga publikimet e DPS, shpërndarë gjatë takimit:

Katalogu i Standardeve Shqiptare 2014

Rreth **60** Katalogë të Standardeve Shqiptare, **25** në format letër dhe **35** në format elektronik (CD).

Fletëpalosje

- “Standardet – Rreth DPS”;
- “Si të marrim pjesë në procesin e standardizimit”
- “Ju jetoni 24 orë me standarde”.

Broshura

- Përfitimet nga standardet;
- Standardizimi, një garanci më shumë për cilësinë dhe sigurinë e produkteve;
- Sistemet e Menaxhimit Mjedisor për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme;
- Udhëzuesi i Menaxhimit të Shërbimeve;
- Standardizimi për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme.